

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR
PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR ADMINISTRIMIN E
OBJEKTEVE TË KONFISKUARA SI NDËRTIME PA LEJE ME
QËLLIM PËRDORIMIN E TYRE PËR INTERES PUBLIK APO
STREHIM SOCIAL SI DHE ZBUTJEN E PASOJAVE SOCIALE TË
SHKAKTUARA”.

I. QËLLIMI I PROJEKT-AKTIT DHE OBJEKTIVAT QË
SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projekt-aktit është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe instrumenteve ligjore, financiare dhe teknike për zbutjen e pasojave që vijnë nga ndërtimet pa leje apo në tejkalim të lejes së ndërtimit, në vijim të konfiskimit për interes publik të këtyre objekteve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu ky ligj ka në fokus edhe përcaktimin e kompetencave dhe detyrave të autoriteteve publike përgjegjëse të përfshira në proceset e zhvillimit dhe administrimit të objekteve të konfiskuara, si dhe parashikimin e programeve që synojnë zbutjen e pasojave sociale ndaj të tretëve për shkak të konfiskimit të objekteve.

Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, pësoi ndryshime të rëndësishme në tërësinë e tij sa i takon përcaktimit të masave ndaluese për ndërtimet pa leje, institucionet përgjegjëse për dhënien e lejeve të zhvillimit të ndërtimit, llojet e zhvillimit kompleks që lidhen me çështje, zona, objekte të rëndësishme kombëtare apo me investime strategjike për interesat e vendit etj.

Në koherencë me këto ndryshime të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë dhe me detyrat e lëna prej këtij të fundit për Këshillin e Ministrave, u miratua Vendimi Nr. 589, datë 7.9.2022 “Për rregullat dhe procedurat për konfiskimin për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, për qëllim fitimi”, që përcaktoi në mënyrë shteruese dhe të qartë, masat parandaluese që duhet të ndërmerren në rastet e ndërtimeve pa leje dhe të atyre ndërtimeve që janë në shkelje të lejes së ndërtimit.

Kjo nismë lidhet me programin e Këshillit të Ministrave për të arritur objektivat në parandalimin e dëmeve që mund të shkaktohen nga ndërtimet pa leje apo në shkelje të lejes, do të plotësojë kuadrin ligjor si dhe për rregullimin dhe zbutjen e pasojave sociale dhe urbane të shkaktuara nga ndërtimet për qëllim fitimi në kundërshtim me ligjin, për të tretët që në mirëbesim, i cënohen interesat pasurore nga konfiskimi i objekteve për qëllime fitimi të ndërtuara pa leje apo në tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe të komunitetit në përgjithësi. Një aspekt tjetër që synohet të rregullohet me këtë ligj është procesi i administrimit të objekteve të konfiskuara si ndërtime pa leje për qëllim fitimi në zbatim të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, duke synuar rritjen e vlerës së tyre me qëllim përdorimin për interes publik apo strehim social.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projekt-akt nuk është parashikuar në paketën e planifikuar të projektakteve, por duke marrë parasysh rëndësinë që paraqet kjo nismë, e konsiderojmë të domosdoshëm miratimin sa më shpejt të këtij projekt-akti.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKT-AKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Miratimi i këtij projektligji përveçse do të plotësonte kuadrin ligjor për çështjet e ndërtimit, gjithashtu do të sillte qartësimin e parashikimeve për masat parandaluese të parashikuara në ligj, për të gjitha institucionet ligjzbatuese, si dhe për të gjithë subjektet që mund të preken. Ky projektligj vjen si pjesë e paketës ligjore në kuadër të përmirësimit të procedurave të planifikimit dhe të ndërtimit, me qëllim parandalimin e problematikave në të ardhmen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Përcaktimi i rregullave dhe procedurave të konfiskimit për interes publik të objekteve të ndërtuara pa leje, vijnë si rezultat i ndryshimeve në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij projektligji bëhet përcaktimi i rregullave, procedurave dhe instrumenteve ligjore, financiare dhe teknike për zbutjen e pasojave që vijnë nga ndërtimet pa leje apo në tejkalim të lejes së ndërtimit në vijim të konfiskimit për interes publik të këtyre objekteve në përputhje me parashikimet e ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Gjithashtu janë detajuar kompetencat dhe detyrat e autoriteteve publike përgjegjëse të përfshira në proceset e zhvillimit dhe administrimit të objekteve të konfiskuara parashikimi i programeve që synojnë zbutjen e pasojave sociale ndaj të tretëve për shkak të konfiskimit të objekteve

Në këto kushte, ky projektligj vjen në koherencë me legjislacionin në fuqi dhe në përputhje të plotë me të.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nënndarjes “iii” dhe “iv”, të shkronjës “e”, të pikës 1, të nenit 52 të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKT-AKET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përafron akte me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKT-AKTIT

Projektligji përbëhet gjithsej nga 5 kapituj, 2 seksione dhe gjithësej 32 nene.

Seksioni I

Kreu I-rë “DISPOZITA TË PËRGJITHSHME” parashikon qartazi qëllimin, objektin dhe përkufizimet e termave që përdoren në akt, duke dhënë shpjegime për konkrete.

Kreu i II -të parashikon parimet e këtij ligji që përkufizohen në mbrojtjen sociale, zhvillimin e qëndrueshëm, parimin e kontrollit dhe të transparencës si dhe parimin e informimit publik.

Kreui III-të parashikon autoritetet përgjegjëse për marrjen e masave me qëllim mirëadministrimin dhe përdorimin e objekteve të konfiskuara për interes publik apo strehim social, si dhe të masave për zbutjen e pasojave sociale dhe urbane.

Kreu i IV-ët ka parashikuar procedurën ligjore që do të ndiqet për zhvillimin dhe administrimin e objekteve të konfiskuara, duke i specifikuar në hartimin e programeve të posaçme të zhvillimit.

SEKSIONI II

Një vëmendje i është dhënë procedurave të përshpejtuara dhe lehtësirave të mundshme ligjore që do të aplikohen për përfundimin e objekteve të konfiskuara

dhe zhvillimin e tyre.

Kreu V ka parashikuar dispozitat e fundit, si dhe janë parashikuar edhe lista e akteve nënligjore që do të miratohen për zbatimin e këtij ligji.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet autoritetet përgjegjëse të parashikuara si dhe autoritetet e planifikimit të përcaktuara në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projekt-akti është hartuar nga grupi i Punës i ngritur me Urdhërin nr.200 datë 16.12.2022 të Kryeministrit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projekt-aktit shoqërohet me shpenzime shtesë financiare për Buxhetin e Shtetit, të cilat do të programohen sipas ligjit “Për Buxhetin”.

MINISTRI

DELINA IBRAHIMAJ